



Pranimi / Dorezuar Primen / Primalo Received / Delivered	10 - 10 2022	2	viti god year
Organ / Niveli Organ / Jednotka Org. / Unit	SKOMBICK	6046/2022	115
Do Prof. Pril. No.		Shkronja Pril. / Zgjedhja	Sasia Policina Quantity



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.739/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardit Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.739/2022 të datës 26.08.2022 të parashtruar nga kundër Komunës se Prizrenit, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e jashtafatshme ankesa A.nr.739/2022 e datës 26.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Komunën e Prizrenit, më datë 26.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4986 të regjistruar me shenjen A.nr.739/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave me datë 31.08.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Komunën e Prizrenit, ndërsa me datë 09.09.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4986/2022 të datës 26.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 17.04.2018 për ankuesin; Njoftimin e datës 31.03.2022 nga ankuesi për Shefin e Sektorit të Arsimit; Kërkesë për vlerësimin e rezultateve në punë nga ankuesi për Shefin e Sektorit të Arsimit të datës 11.03.2022; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.03.2022 nënshkruar nga ankuesi; Emailin e datës 13.01.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 11.01.2021 nga ankuesin; Emailin e datës 21.12.2020 nga ankuesi; Emailin e datës 31.03.2022, 10.03.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 06.502.222 nga ankuesin; Emailin e datës 11.05.2022 nga ankuesi për Reagim-Kërkesë të datës 11.05.2022 nga ankuesi; Planifikimi Vjetor për vitin 2021 nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren të datës 06.01.2021; Plani Javor i vizitave në Shkolle për datën 19-23.04.2021 nga zyrtarët e Sektorit të Arsimit; Plani Javor i vizitave në shkollë për datën 06.05.2021 nga Zyrtarët e Sektorit të Arsimit; Raporti i vizitës në Gjinnazin Gjon Buzuku të datës 26.04.2021; Raporti përmbledhës i shkurtër dhe vlerësues holistik mbi pasqyrimin e gjendjes së vizituar të datës 22.04.2021 në Gjinnazin Gjon Buzuku; Raporti i vizitës në Gjinnazin e datës 22.04.2021; Raporti përmbledhës i shkurtër dhe vlerësues holistik mbi pasqyrimin e gjendjes së vizituar të datës 22.04.2021 në Gjinnazin Raporti i vizitës në SHFMU të datës 12.05.2021; Raporti përmbledhës i shkurtër dhe vlerësues holistik mbi pasqyrimin e gjendjes së vizituar të datës 06.05.2021 në SHMU Mustafa Baku; Raporti i vizitës në SHFMU Motrat Qiriazi të datës 22.04.2021; Raporti përmbledhës i shkurtër dhe vlerësues holistik mbi pasqyrimin e gjendjes së vizituar të datës 20.04.2021 në SHMU Motrat Qiriazi; Raporti i vizitës në Shkollën Mati Logoreci të datës 25.04.2021; Raporti përmbledhës i shkurtër dhe vlerësues holistik mbi pasqyrimin e gjendjes së vizituar të datës 22.04.2021 në Shkollën Mati Logoreci; Raporti i vizitës në SHFMU Lekë Dukagjini të datës 12.05.2021; Raporti përmbledhës i shkurtër dhe vlerësues holistik mbi pasqyrimin e gjendjes së vizituar të datës 06.05.2021 në SHFMU Lekë Dukagjini; Raporti i vizitës në SHFMU Lekë Dukagjini 0-5 të datës 14.05.2021; Raporti përmbledhës i shkurtër dhe vlerësues holistik mbi pasqyrimin e gjendjes së vizituar 0-5 të datës 11.05.2021 në SHFMU Lekë Dukagjini; Raporti i vizitës në Shkollën Xhevat Berisha të datës 24.05.2021; Raporti përmbledhës i shkurtër dhe vlerësues holistik mbi pasqyrimin e gjendjes së vizituar të datës 20.05.2021 në Shkollën Xhevat Berisha; Raporti i vizitës në Shkollën Hasim Maliqaj të datës 24.05.2021; Raporti përmbledhës i shkurtër dhe vlerësues holistik mbi pasqyrimin e gjendjes së vizituar të datës 20.05.2021 në Shkollën Hasim Maliqaj; Emaili i datës 26.04.2021 nga ankuesi për ankuesin; Emailin e datës 26.04.2021 nga ankuesi për lidhur me raportet e vizitave në shkollë sipas planit Javor 19-23.04.2021; Raport-Organizimi dhe mbajtja e maturës shtetërore 2021 të datës 28.06.2021 nënshkruar nga ankuesi; Raport-Organizimi dhe mbajtja e maturës shtetërore 2021 afati i gushtit të datës 30.08.2021 nënshkruar nga ankuesi; Emailin e datës 10.06.2021 nga ankuesi për Xh. Vezgishi; Shkresë për olimpiadën matematike të Kosovës 2021 të datës 22.02.2021; Emailin e datës 16.12.2021 nga ankuesi për Raporti i Planifikimit dhe organizimit të trajnimeve të mësimdhënësve në implementimin e kurikulës së re në nivelin e arsimit parauniversitar në Komunën e Prizrenit të datës 02.11.2021 nënshkruar nga ankuesi; Vendimin me Nr.01/060-96353 të datës 18.09.2020 për emërimin e koordinatorit dhe caktimin e zyrtarëve komunal për raportin e performancës;

Vendimin e datës 20.05.2021 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit të datës 18.09.2020; Emailin e datës 27.10.2021 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 27.10.2021 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 14.10.2021 nga _____ për _____ Emailin e datës 20.10.2021, 07.06.2021 nga ankuesi; Shkresë me titull Vlerësimi i Protfoliove të Mësimdhënësve; Përmbledhje statistikore të projekteve/shërbimeve që janë të ngjashme; Raporti vjetor 2021 të Drejtorisë Komunale të Arsimit me Nr. Protokolli 3446/21_1 i datës 24.12.2021 nga ankuesi; Raporti vjetor 2021 të Drejtorisë Komunale të Arsimit me Nr. Protokolli 3446/21_2 i datës 24.12.2021 nga ankuesi; Raporti tremujor janar-mars 2021 i datës 23.04.2021 nga ankuesi; Planifikimi Mujor për Zyrtaret Arsimit të DKA-së; Raporti për muajin maj, prill 2021; Raporti javor për 0-8-12.03.2021 nënshkruar nga ankuesi; Emailin e datës 26.08.2022 nga ankuesi për ankesa.kpmsnck@rks-gov.net; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 31.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 09.09.2022; Planifikimin vjetor për vitin 2022 për Drejtorin Komunale të Arsimit-Prizren; Emailin e datës 29.04.2022 nga _____ për _____ Emailin e datës 23.05.2022 nga _____ për _____ dhe ankuesin; Emailin e datës 18.05.2022 nga _____ për _____ Emailin e datës 05.07.2022, 04.07.2022 nga _____ për ankuesin; Emailin e datës 04.07.2022 nga ankuesi për _____ Emailin e datës 04.07.2022 nga _____ Kërkesë për pushim vjetor e datës 28.06.2022 nga ankuesi; Përshkrimin e detyrave të punës Zyrtar për Arsim të Mesëm të Lartë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.739/2022 e datës 26.08.2022, e parashtruar nga ankuesi _____ është e *jashtafatshme*, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Shkresën e Emërimit me numër protokolli 01-112-10576 të datës 18.01.2018 rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtar për Arsimin e Mesëm të Lartë në Drejtorinë e Arsimit pranë Komunës së Prizrenit*.

Kolegji i Këshillit me rastin e shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi me datë 24.12.2021 dhe me datë 11.03.2022 ka dërguar të mbikëqyrësi i drejtpërdrejt formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, së bashku me raportin vjetor 2021 dhe planifikimin për vitin 2022. Po ashtu nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi me datë 31.03.2021 kishte parashtruar kërkesë të Shefi i Sektorit të Arsimit duke kërkuar përgjigje me shkrim lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, ndërsa ky i fundit në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesi, më datë 29.04.2022 ka njoftuar Drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prizrenit se nuk mund të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin me arsyetimin se i njëjti nuk ka respektuar nenin 43 pika 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe nenin 6, 7 dhe 8 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, për shkak se ankuesi ka anashkaluar njëanshëm dhe pa ndonjë arsye autoritetin mbikëqyrës dhe nuk ka shprehur interesim për të bashkëpunuar duke pasur bashkëpunim dhe komunikim të drejtpërdrejtë vetëm me ish Drejtoreshën e DKA-së.

Kundër përgjigjes me shkrim të datës 29.04.2022 të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt, ankuesi me datë 11.05.2022 kishte reaguar me shkrim të Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së



Prizrenit, ndërsa me datë 26.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për detyrimin e organit të punësimit për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021, sipas njoftimit me numër 1066/22 të datës 31.03.2022.

Kolegji i Këshillit bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sjell në vëmendje faktin se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji.

Me tutje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 43 paragrafi 1 përcaktohet se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues.*

Andaj, me qëllim të vlerësimit të pranueshmerisë së ankesës, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 125 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative"),* si dhe nenit 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, dhe paragrafin 4 ku përcaktohet se: "Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ",* dhe si rrjedhojë duke ju referuar këtyre dispozitave ligjore Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar me datë 26.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e jashtafatshme, sepse vlerësimi i rezultateve të punës bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues, që nënkupton se ankuesi ka mundur të parashtroj ankesë ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 për përfundimin e procedurës administrative, por në rastin konkret i njëjti nuk e ka shfrytëzuar këtë të drejtë.

Për me tepër ankuesi me datë 29.04.2022 ka qenë i njoftuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë se nuk do t'i bëhet vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, si dhe arsyet e dhëna lidhur me mos vlerësimin e rezultateve të punës, në lidhje me çka i njëjti me datë 11.05.2022 ka reaguar me shkrim të Drejtoresha e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prizrenit, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datë 26.08.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim edhe me paragrafin 1 të nenit 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, për sa me sipër është konstaton se ankesa e ankuesit është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën

paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.739/2022

Flakron Gashi

Procesmbajtës



Jeton KOCA

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Shefi të Sektorit të Arsimit në Komunën e Prizrenit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.